

## *Terminologjia e përdorur në Platformën për Krahasimin e Produkteve dhe Shërbimeve Financiare*

*Perkufizimet e përdorura në këtë dokument janë vetëm për qëllime të platformës*

**IF** - Institucion financiar i licencuar dhe rregulluar nga BQK për dhënien e kredive, përfshirë bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jo-bankare.

**Konsumator** – nënkupton çdo person fizik që vepron për qëllime që nuk kanë të bëjnë me ushtrimin e tregtisë, biznesit, zanatit ose profesionit vetanak;

**Tarifa** – nënkupton të gjitha ngarkesat të pagueshme nga konsumatori tek banka për apo në lidhje me shërbimet e ofruara;

**Fonde** – nënkupton paratë e gatshme, kartëmonedhat dhe monedhat euro;

**Kartelë** – çdo kartelë, duke përfshirë kartelën për debit, kredit, bankomate dhe pika të shitjes, që shfrytëzohen nga klienti për të kryer një transferim të fondeve, dhe duke përjashtuar kartelat e lëshuara nga tregtarët vetëm për përdorim në dyqanin apo në rrjetin e dyqaneve të tyre;

**Definicionin e normës se interesit:** nënkupton normën e interesit të shprehur si përqindje fikse apo të ndryshueshme e aplikuar në bazë vjetore në shumën e aprovuar të kredisë apo në shumën e depozitës së pranuar nga banka;

**Norma fikse e interesit** - është norma e interesit që mbetet e pandryshuar gjatë gjithë periudhës së kredisë, duke siguruar pagesa mujore të njëjta dhe stabilitet financiar për kredimarrësin.

**Norma e ndryshuar e interesit** – është norma e interesit që mund të ndryshoj gjatë kohëzgjatjes së kredisë varësisht nga ndryshimi i një indeksi të paracaktuar, në të cilin ka qasje publike dhe i cili është jashtë kontrollit të IF.

**Norma e kombinuar e interesit** – nënkupton një normë interesi që fillimisht aplikohet si norme fikse për një periudhë të caktuar dhe më pas ndryshon në një normë të ndryshueshme deri në përfundimin e kredisë. Periudha e normës fikse të interesit mund të ndryshojë nga një institucion financiar në tjetrin.

**Norma nominale e interesit** - është shkalla e interesit e shprehur si përqindje fikse apo e ndryshueshme e deklaruar nga një institucion financiar, e cila përfaqëson përqindjen e kthimit që një individ do ta paguajë për një kredi ose përqindjen e interesit që e përfiton individi nga një depozitë.

**Norma Efektive e Interesit - NEI**” - nënkupton koston totale të kredisë ose kthimin e depozitës, të paraqitur si normë vjetore e vlerës totale të kredisë ose kthimit total nga depozita e llogaritur sipas metodologjisë së kërkuar sipas Rregullores së BQK për Normën Efektive të Interesit dhe Kërkesat për Shpalosje. Ajo përfaqëson shkallën e vërtetë të interesit që një individ paguan për një kredi ose përfiton nga një depozitë.

**Tarifa e disbursimit apo shpenzimet administrative** - Është një tarifë që i ngarkohet kredimarrësit nga IF për të zotuar burimet e tyre dhe për të lidhë marrëveshje për kredi me kredimarrësin. Shuma e saktë që ngarkohet është e ndryshme. IF pëson shpenzime administrative në lidhje me procesin e kredisë. Kjo tarifë po ashtu mund të adresohet si tarifë zotimi, tarifë administrative apo tarifë menaxhimi.

**Llogaria rrjedhëse** – është llogari bazike që përdoret nga individë e cila ju mundëson qasje të shpejtë në financat e tyre për t’i përdorur për transaksione të shpeshta si: deponime dhe tërheqje, pagesa të faturave, pranimin e pagës / qerasë, pagesat e kredisë, për të shfrytëzuar shërbime të tjera përmes kartelave të bankës, e-Banking / mobile Banking.

**Llogari e kursimit** – është llogari bankare e dizajnuar për t’i ndihmuar individët që të kursejnë para dhe të rrisin kursimet e tyre. Në llogarinë e kursimit, individët mund të deponojnë fondet e tyre me qëllim të kursimit, të përfitojnë interes dhe të kenë mundësi t’i përdorin ato në çdo moment.

**Llogaria e kursimit për fëmijë** – është llogari bankare e dizajnuar për të mundësuar depozitim të fondeve në llogari me qëllim që t’i ndihmojnë fëmijët për të ardhmen e tyre. Kjo llogari u mundëson fëmijëve të zhvillojnë aftësi financiare dhe i ndihmon të kuptojnë rëndësinë e kursimit dhe menaxhimit të parave. Fondet e grumbulluara në llogari, fëmijët mund të i shfrytëzojnë pasi të kenë arritur moshën madhore.

**Llogari pagese me shërbime bazike** – është llogari që ofron grup shërbimesh bankare bazike të cilat konsumatorët mund t’i përdorin me kosto më të ulët ose falas. Bankat mund të përcaktojnë tarifa më të ulëta (ose edhe të ofrojnë këto shërbime krejtësisht pa pagesë), por në asnjë mënyrë nuk mund të përcaktojnë tarifë më të lartë se 0,12% e vlerës së pagës mesatare neto mujore në Republikën e Kosovës, e publikuar së fundmi nga Agjencia e Statistikave të Kosovës.

**Llogari studentore** – është llogari bankare e krijuar posaçërisht për studentët në arsimin e lartë. Kjo llogari është krijuar për t’i ndihmuar studentët në menaxhimin e financave të tyre gjatë kohës së studimeve.

**Llogari pagese me shërbime bazike për kategori të konsumatorëve të cenueshëm** – është llogari që ofron grup të shërbimeve bankare bazike të cilat konsumatorët mund t’i përdorin pa kosto / falas. Të drejtë për hapje të kësaj llogarie kanë grupet e përcaktuara të konsumatorëve (shih listën në linkun e bashkangjitur).

**Kartelë** – çdo kartelë, duke përfshirë kartelën për debit, kredit, bankomate dhe pika të shitjes, që shfrytëzohen nga klienti për të kryer një transferim të fondeve, dhe duke përjashtuar kartelat e lëshuara nga tregtarët vetëm për përdorim në dyqanin apo në rrjetin e dyqaneve të tyre;

**Kartela Debitore** – është e lidhur drejtpërdrejte me llogarinë bankare dhe është një mjet i dobishëm për menaxhimin e përditshëm të financave. Kartela e debitit mundëson tërheqjen dhe deponimin e parave nga bankomatët (ATM), pagesën për produkte dhe shërbime nëpërmjet terminaleve POS, kryerjen e pagesave online, kontrollimin e gjendjes së llogarisë.

**Kartela Kreditore** - është kartelë e cila lejon huazimin e mjeteve nga banka për të kryer pagesa të ndryshme ose për tërheqjen e mjeteve nga bankomatët (ATM). Mjetet të cilat përdoren janë huazime nga banka për të cilat klientët paguajnë interes bankës.

**Kredia** – nënkupton çdo hua ose zotim ligjor direkt apo indirekt për dhënien e një shume parash me të drejtën e kthimit të asaj shume të dhënë dhe të papaguar dhe të pagesës së interesit ose ndonjë detyrimi tjetër në atë shumë;

**Kredi për banim** – është lloj kredie që përdoret për të financuar blerjen, ndërtimin e një shtëpie / banese. Këto kredi janë të njohura edhe si kredi hipotekare ose kredi për shtëpi dhe janë një nga format më të zakonshme të huamarrjes afatgjatë për individët dhe familjet. Këto kredi zakonisht ofrohen për periudha afatgjata deri në 30 vite dhe mbulohen me kolateral të paluajshëm / pronë.

**Kredi për Renovim** - është një lloj kredie që përdoret për të financuar përmirësimet ose riparimet e një prone ekzistuese. Shuma e kredisë varet nga kostoja totale e renovimit.

**Kredi personale** - është një lloj kredie që përdoret për të financuar shpenzimet personale të ndryshme, si blerjen e mallrave të konsumit, udhëtime, pajisje elektronike, mobileje, dhe shpenzime të tjera të përditshme. Këto kredi janë zakonisht afatshkurtra dhe nuk kërkojnë kolateral, duke i bërë ato një zgjedhje të popullarizuar për huamarrësit që kanë nevojë për fonde të menjëhershme.

**Kredi për vetura** - është një lloj kredie që përdoret për të financuar blerjen e një automobili të ri ose të përdorur. Shuma e kredisë varet nga kostoja totale e automjetit dhe përqindja e parapagimit. Zakonisht, automjeti që financohet lihet pengë për kredinë deri në shlyerjen totale të saj.

**Kredi të mbuluara me para të gatshme** - është një lloj kredie që është e siguar zakonisht me para të gatshme ose depozita në një llogari bankare. Në rastin e këtij lloji kredie, huamarrësi ofron para të gatshme ose një depozitë si kolateral për të siguar kredinë. Zakonisht, për këtë lloj të kredisë bankat ofrojnë interes më të ulët në krahasim me llojet e tjera të kredive.

**Mbitërheqje** – nënkupton një marrëveshje të kredisë me anë të së cilës një ofrues i shërbimit të pagesave vë në dispozicion të konsumatorit një fond që tejkalon bilancin aktual në llogarinë e pagesës së konsumatorit.

**Depozitë** - nënkupton shumën e parave të paguara nga një person fizikë apo juridikë në bankë, e cila pranohet nga banka me kusht që të ri-paguhet plotësisht, me ose pa interes ose premium, qoftë me kërkesë të ose në kohën e caktuar sipas marrëveshjes me atë person fizikë apo juridikë;

**Pakot bankare** - janë grupe të ndryshme shërbimesh që bankat ofrojnë si një pako të vetme për klientët e tyre. Këto pako zakonisht përfshijnë një kombinim të produkteve dhe shërbimeve bankare që janë krijuar për të përmbushur nevojat e veçanta të klientëve. Pakot e shërbimeve bankare ofrojnë përfitime të shtesë krahasuar me shërbimet individuale dhe shpesh janë të dizajnuara për të ofruar lehtësira dhe kursime për klientët